

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"A doni të blini armë nga SHBA?" - Trump ia bëri pyetjen Xi Jinping, Departamenti i Shtetit jep sqarimin
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/a-doni-te-blini-arme-nga-shba-trump-ia-beri-pyetjen-xi-jinping-departamenti-i588983
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 14:31:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fe6e00078f1b6f2fdc09a8c7f44b279ae4aee09b65bf33d043d57320560922c
TEKSTI	eb6eaa5b3a06c4da359e24ccc81288d2c86ba81110866380df39b48fa9567836
PAMJA	2c913b2fcfa0c7dc37dacfcd3da140fb0e5272c8e6526765e83477579e5f82c2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	74ff44fb56a78fa9744b58b7e1db15daa898748f196054e86b8f06bbae0ff680
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/74ff44fb56a78fa9744b58b7e1db15daa898748f196054e86b8f06bbae0ff680>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

1 e [Kriza e emigranteve, përfaqësuesi i qeverisë spanjolle në Ceuta jep doreheqjen. Irani ankese në OKB për sanksionet amerikane në sektorin e aviacionit](#) Meta i bllokoi Lulë fundit

“A doni të blini armë nga SHBA?” - Trump ia bëri pyetjen Xi Jinping, Departamenti i Shtetit jep sqarimin



28 Shtator 2026, 17:50 Bota TEMA



Presidenti amerikan Donald Trump e ka pyetur udhëheqësin kinez Xi Jinping nëse Kina dëshironte të blinte armë nga Shtetet e Bashkuara. Kështu deklaroi ambasadori amerikan në Pekin, David Perdue, duke iu referuar takimit të dy presidentëve javën e kaluar në Uashington.

Por pas deklaratës së tij, Departamenti amerikan i Shtetit sqaroi se ligji ndalon shitjen e armëve Kinës dhe se nuk ka asnjë ofertë apo plan për një marrëveshje të tillë. Edhe Shtëpia e Bardhë tha se nuk ka plane për t'i shitur armë Pekinit.

Deklarata vjen në një moment të ndjeshëm për Tajvanin. Ishulli pret prej muajsh miratimin nga Trump të një pakete armësh amerikane me vlerë 14 miliardë dollarë. Në maj, presidenti amerikan tha se e kishte lënë pezull vendimin, duke e cilësuar paketën si një mjet të mundshëm negociimi me Kinën.

Pekini kundërshton shitjen e armëve amerikane për Tajvanin, të cilin e konsideron pjesë të territorit të vet. Një zyrtar i lartë tajvanez tha se ishulli përballet me një kërcënim të rëndë ushtarak nga Kina. Sipas tij, Uashingtoni i kupton nevojat e Tajvanit për mbrojtje.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

[Kriza e emigrantëve, përfaqësuesi i qeverisë spanjolle në Ceuta jep dorëheqjen](#)

16:30 Bota

Irani ankesë në OKB për sanksionet amerikane në sektorin e aviacionit

16:20 Bota

[Meta i bllokoi Lula-s reklamat e fushatës pak ditë para zgjedhjeve presidenciale në Brazil](#)

16:16 Bota

[213 lekë për litër, çmimi i naftës në Mbretërinë e Bashkuar arrin nivelin më të lartë historik](#)

15:50 Bota / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.